



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 41, datë 28.02.2019

**PËR
NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 35, DATË 19.02.2019 TË KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR “PËR CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE
GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO
KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 4, 147/1/A të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 2 dhe 89 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë”, në vendimin nr. 30, datë 14.02.2019 “Mbi miratimin e Vendimit për rregullat e një çështje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në kushtet e pazbatueshmërisë aktuale të neneve 45 dhe 46 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kushtet kur gjatë procedurave të shortit, në funksion të vendimit nr. 35, datë 19.02.2019, të jetë ometuar zhvillimi i shortit për caktimin e gjyqtarit në 2 çështje, për të cilat është kërkuar caktimi i 1 (një) gjyqtari,

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 35, datë 19.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, bëhen shtesat e mëposhtme:

1.1 Në pikën I, në nënndarjen Gjykata e Apelit Gjirokastrë, pas pikës 5, shtohen:

- i. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}; akuza: “Dhunë në familje”.
- ii. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me paditës: {...},

{....}, {....}, etj., të paditur: {....}; person i tretë: {....} Gjirokastrë, Shoqëria {....}, Shoqëria {....}, etj.; objekti: “Pagim dëmi pasuror dhe jo pasuror, etj.”.

2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR

KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR